

INSTITUTI I KURRIKULËS DHE STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR

LËNDA: GJUHA AMTARE

(Klasa e katërt)

Tiranë, 2006

I.TË PËRGJITHSHME

Roli i mësimit dhe zotërimit të gjuhës amtare në shkollë është parësor dhe në qendër të edukimit të nxënësve, për të ardhmen, jetën dhe veprintarinë e tyre në të. Si e tillë Gjuha Amtare është lënda që bën të mundur zhvillimin e aftësive komunikative për qëllime të gjithanshme, ajo jep mundësi për zhvillimin dhe formimin intelektual, etik, estetik dhe qytetar të nxënësve .

Zotërimi i Gjuhës Amtare nga nxënësit e klasës IV do të arrihet nëpërmjet alternimit në mënyrë funksionale të njohjes së strukturave gjuhësore me shprehitë komunikative, për të mundësuar aftësimin dhe zbatimin e ndërgjegjshëm nga ana e nxënësve në përdorimin e gjuhës si:

në nivel vetjak, në situata të ndryshme konkrete komunikuese, për të transmetuar përvojat feminare, ndjenjat, mendimet dhe idetë e tyre, ashtu dhe në nivelin standard të gjuhës me qëllim që të arrihet t'i jepet kuptimtë të menduarit dhe e të komunikuarit nëpërmjet të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit.

E parë në këtë këndvështrim, realizimi i këtij programi për klasën IV do të arrihet nëpërmjet riorganizimit funksional të përbërësve të lëndës së Gjuhës Amtare; kulturës së të dëgjuarit, të të folurit, të shkruarit e strukturuar me drejtshkrim e pikësim , gjë që mundësohet dhe nga karakteri intuitivo-praktik i njohurive dhe aftësive të moshës. Kjo mundësohet edhe për faktin se vetë truri i fëmijës është i modeluar të mësojë gjuhë, çka bën të mundur pasurimin e përvojave gjuhësore dhe komunikuese të tij, për t'i dhënë Gjuhës Amtare karakterin e vërtetë identifikues.

Veçori e zhvillimit të lëndës në klasën IV është se, studimi i Gjuhës Amtare synon t'u japë nxënësve krahas **shprehive komunikuese**, të cilat u nevojiten për të komunikuar për nevoja vetjake në shkollë e më gjërë si qenie shoqërore, edhe njohuri rreth **sistemit gjuhësor**, domethënë, rregullat më të përgjithshme të sistemit gramatikor. Rregulla që vijnë duke u zgjeruar në përshtatje të rritjes edhe të interesave jetësore të vet fëmijës për një komunikim vlerash njerëzore. Për këtë arsye edhe raporti i përqindjes së orëve do të anojë nga shprehitë komunikuese. (70% me 30% e lëndës mësimore)

Lënda e Gjuhës Amtare në klasën IV ka si veçori vazhdimin dhe çuarjen më tej cilësisht të angazhimit profesional, qytetar e misionar në dhënien e njohurive gjuhësore e komunikuese sipas parimeve specifike të organizimit të strukturës e të përmbajtjes së saj, përcaktuar në Kurrikulën e Re të 2004-ës për Mësimin e Gjuhës Shqipe në Shkollë për klasat (1-9)

Gjithashtu në përputhje më kërkesat e didaktikës bashkëkohore për të edukuar të menduarit kritik dhe krijues në kuadrin e punës për të formuar nxënës, qytetarë të denjë për një shoqëri të hapur, ku mësuesi dhe nxënësi jo vetëm të përfshihen në procesin e ndryshimit, por të ndihen dhe të jenë realisht palë aktive, autorë dhe aktorë në këto hapa ndryshimi. Përmes këtyre hapave ndryshues programi i kësaj lënde në klasën IV rreh të sjellë dhe të krijojë disa hapsira dhe mundësi konkrete për risi të mirëfillta.

Në klasën IV njohuritë gjuhësore do të shënojnë rritje në raport me ato të klasës pararendëse dhe kthimi i tyre në shprehje do të kalojë përmes një strategjie të re, e cila konsiston në kërkimin, gjetjen dhe përdorimin e teknikave bashkëkohore për të realizuar dhënien, asimilimin dhe praktikimin e përmbajtjes si më poshtë:

njohuri për komponentët të rëndësishëm të lëndës së Gjuhës Amtare

aftësi komunikuese me gojë dhe me shkrim në procesin mësimor dhe më gjerë nxitjen tek nxënësi i qëndrimeve vlerësuese e vetvlerësuese me qëllim që përmes gjuhës amtare

1. të mund të krijojë nocione,
2. të formatojë koncepte në përshtatje me moshën,
3. të marrë dhe të transmetojë mesazhe që do të jenë çelësa në shërbim të vetvetes për të njohur dhe t'u njohur në mjedisin ku jeton.

Janë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që ai mban ndaj sistemit të shenjave dhe rregullave gjuhësore ato që e bëjnë të arrijë të komunikojë saktë, të njohë suksesin në rrethin e tij shoqëror, në familje dhe më gjerë. Nxënësi përmes këtij trekëndëshi të qëndrueshëm dijesh, shprehish dhe qëndrimesh nëpërmjet së cilës do të arrijë të njohë, të japë mendime, të japë gjykimet e tij jo vetëm në lëndën e gjuhës amtare, por në të gjitha lëndët që zhvillohen në klasë. Në këtë dritë ajo përbën një ndërëndë.

Mësimi tematik i gjuhës amtare mundëson që njohuritë gjuhësore të jepen nëpërmjet situatave tematike të caktuara, ku ndërthuren komunikimi dhe njohuritë mbi strukturën e gjuhës së folur e të shkruar dhe kërkon që nxënësi të zbulojë dhe vrojtojë në mënyrë analitike :

Marrëdhënie të caktuara shoqërore të jetës si: familja, shoqëria, shkolla, mësimi, tregëtia, miqësia, toleranca etj.

Identitetin e tyre kulturor, nga i cili njehtë shkuarën e të tashmen, historinë, traditat, kulturën, folklorin etj.

Në përshtatje me psikologjinë moshore do të bëhet kujdes të vendoset nxënësi brenda një **kulture paqeje** dhe respekti për ata që janë ndryshe. Kjo klimë humanizmi, dashurie për shokun, solidariteti u jepet nxënësve në vazhdë e vlerave të popullit tonë është në të vërtetë sa e vjetër aq edhe e re.

Risia në këtë përbërës që ka një rëndësie themelore dhe që duhet trajtuar me profesionalizëm, është përzgjedhja e metodave ndërvepruese dhe teknikave bashkëkohore që do të ndiqen për t'i zhvilluar orët e Gramatikës së gjuhës amtare dhe komponentët a saj si: shqiptimi, drejtshkrimi, pikësimi, leksiku, gramatika, morfologjia dhe sintaksa, rendi i fjalëve në fjali, kultura gjuhësore. Kjo bën që konceptimi i lëndës së gjuhës amtare të jetë vendosja e njohurive gramatikore në shërbim të shprehive komunikuese, pra **nuk do të nisët nga gramatika, por do të shkohet drejt saj.**

I rëndësishëm po aq dhe që do të riorganizojë jo vetëm strukturën por edhe përmbajtjen e mësimit të gjuhës amtare do të jetë ai i integritetit të gjuhës shqipe me leximin letrar. Në Kurrikulën e Re të Gjuhës shqipe në shkollë 2004 për klasat I-IX theksohet se: “Programi dhe të mësuarit e integruar ndihmon nxënësit të gjejnë shpejt dhe me lehtësi informacionin që u duhet, ta përpunojnë atë duke zbatuar aftësitë e fituara, duke i nxitur të mbajnë qëndrim dhe të marrin vendime për probleme të ndryshme në situata të caktuara të njohura ose jo, në shkollë dhe jashtë saj”.

Qëllimi i mësimit të gjuhës amtare në klasën e katërt të Ciklit Fillor, si lëndë parësore dhe me karakter kombëtar është formimi i përgjithshëm intelektual dhe komunikues i çdo individi për realizimin e marrëdhënieve shoqërore. Ato realizohen përmes gjuhës dhe formimit të nxënësit me shprehje të plota dhe të qarta gjuhësore që do ta aftësojnë të përdorë

gjuhën amtare në nivel të pranueshëm nga të tjerët gjatë të folurit, të lexuarit e të shkruarit. .

II. SYNIMET E LËNDËS SË GJUHËS AMTARE NË KLASËN IV JANË:

1. Nxënësi të komunikojë me të tjerët për qëllime e situata të ndryshme jetësore duke u aftësuar në përdorimin me saktësi të koncepteve gjuhësore dhe në raporte bashkëveprimi me njohuritë letrare nëpërmjet të folurit, të lexuarit e të shkruarit.
2. Të rritë në mënyrë graduale aftësitë shprehëse, në përshtatje me karakteristikat e moshës, zhvillimit të tij emocional, shoqëror, estetik e moral.
3. Të përdorë me vetëdije drejt, lirshëm njohuritë, konceptet gjuhësore e letrare nëpërmjet shprehjes së informacioneve, ndjenjave, ideve, imagjinatës dhe qëndrimeve të pranueshme për zhvillimin e tyre gjuhësor dhe intelektual duke krijuar marrëdhënie nëpërmjet: dialogut, lojës, tolerancës dhe bashkëpunimit.
4. Të zhvillojë vetndërgjegjësimin e nxënësve për identitetin e tyre kulturor duke fituar edukatën e të lexuarit gjatë tërë jetës material letrar dhe joletrar.

III. LINJAT DHE NËNLINJAT E PËRMBAJTJES

1. Të dëgjuarit & Të folurit

- * Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime në mënyrë individuale dhe në grup.
- * Të dëgjuarit dhe të folurit në grup dhe në publik me shumëllojshmëri qëllimesh.
- * Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme.
- * Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe të gjinive letrare.
- * Të folurit duke përdorur njohuritë rreth gjuhës standarde.

2. Të lexuarit

- * Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion.
- * Të lexuarit për dëshirë që të zgjerojë e të pasurojë horizontin e dijeve nga fusha të ndryshme të shkencës, botës dhe mjedisin që e rrethon.
- * Të lexuarit për dëshirë, për zhvillimin e ndjenjave dhe zgjim imagjinate, që të zgjerojë e të pasurojë botën e tij shpirtërore.
- * Të lexuarit për të mbajtur qëndrim për idetë e pjesës dhe figurat letrare.
- * Të lexuarit e llojeve e të gjinive letrare, të njohë ndarjet dhe nën ndarjet kryesore të letërsisë nga ana formale dhe përmbajtësore.
- * Të lexuarit në heshtje dhe leximi ekspresiv, recitimi .
- * Të lexuarit në praktikim të njohurive rreth gjuhës standarde shqipe.

3. Të shkruarit

- * Të shkruarit funksional duke kuptuar vlerat e shkrimit si element komunikimi.
- * Të shkruarit për nevoja vetjake duke përdorur atë për shumëllojshmëri qëllimesh.
- * Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë, në mënyrë të strukturuar.
- * Të shkruarit për një numër lexuesish duke praktikuar njohuritë e tij rreth gjuhës standarde.

4. Njohuri rreth sistemit të gjuhës

- * Sintaksë
- * Morfologji
- * Leksikologji
- * Kulturë gjuhe
- * Drejshqiptim, drejtshkrim, pikësim.

IV. OBJEKTIVAT DHE TEMATIKAT SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE
LINJA: Të dëgjuarit dhe të folurit -

Nën linjat	Objektivat	Tematika
<p>1. Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime në mënyrë individuale dhe në grup 4 orë</p>	<p>Të dëgjojë me vëmendje dhe të marrë pjesë aktive në komunikim duke dhënë saktë informacione, udhëzime dhe orientime të thjeshta.</p> <p>Të pyesë për çështje e rrethana të veçanta që i interesojnë duke dëgjuar përgjigjet e marra.</p> <p>Të vlerësojë përgjigjet e marra duke shfaqur argumente bindëse gjatë diskutimeve.</p>	<p>Tema nga jeta e ditës: <i>loja, ëndrrat, familja, shkolla, shoqëria</i></p> <p>Tema nga koha e lirë: <i>lojra, veprimtari sportive, biblioteka, Radio TV, gazeta, interneti, udhëtime, shëtitje, turizmi, mjedisi, jeta në shkollë, zbavitje, etj.</i></p>
<p>2. Të dëgjuarit dhe të folurit në grupe të vogla e të gjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të dëgjojë dhe të flasë duke respektuar rregullat e të folurit në grup. ➤ Të përshkruajë në mënyrë të hollësishme ngjarje e situata nga jeta e tij. ➤ Të diskutojë në grup për çështje të caktuara. ➤ Të luajë rolet e caktuara në grupe të vogla dhe të mëdha. ➤ Të vlerësojë dhe të respektojë mendimet dhe idetë e shokëve duke e plotësuar me informacion shtesë planin e grupit. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tema që lidhen me çështjet shoqërore dhe që u përkasin marrëdhënieve ndërmjet njerëzve. <p>Si : paqja , te drejtat, miqësia, konfliktet, toleranca, komunikimi, veprimtaritë e përbashkëta, prezantimet.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Paraqesin duke përshkruar shtete, qytete, lagje, mjedise ku jetojnë njerëz të racave të ndryshme me zakone të ndryshme. ➤ Parashtrajnë plane për veprimtari në grup.
<p>3. Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të flasë për tekste të ndryshme që janë në përshtatje me moshën e tij, që kanë strukturë dhe gjuhë të gjetur si; tregime, vjersha, përralla, fabula, fjalë të urta, poezi, gjëgjëze, 	<p>Tema sipas gjinive e llojeve të ndryshme letrare për të cilat kanë interes fëmijët.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Bisedojnë mbi tekste të ndryshme që kanë lexuar ose dëgjuar. ➤ U përgjigjen pyetjeve të mësuesit për tekste

	<p>gjini të shkurtra dramatike etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ T'u pergjigjet pyetjeve që kanë lidhje me tekste të lexuara ose të degjuara nga të tjerët. <p>Të japë mendime rreth subjekteve dhe personazheve të tyre.</p> <p>Të dallojë diferenca të thjeshta gjuhësore në tekstet që lexon.</p>	<p>të ndryshme letrare dhe joletrare.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Argumentojnë mbi situata të caktuara që kanë lexuar apo emisionet që kanë pare. ➤ Tregojnë përvoja të ngjashme me ato të mesazheve të pjesëve të dhëna.
4. Të dëgjuarit dhe të folurit rreth llojeve dhe gjinive letrare	<p>Të dallojë saktë llojet dhe gjinitë letrare nëpërmjet vjershës, përrallës, tregimit, fabulës, gjëegjëzes, fjalës së urtë, pjesës së shkurtër dramatike.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të krahasojë prozën nga poezia, tregimin nga fabula e përralla, librat nga gazetat. <p>Të përcaktojë intonacionin e zërit në një vjershë, përrallë dhe tregim sipas rregullave të leximit të pjesës përkatesë.</p> <p>T'i zbërthejë duke i renditur ngjarjet sipas rendit të tyre kronologjik në pjesën që lexon</p> <p>Të gjejë titull, hyrje dhe mbyllje të reja në një përrallë ose tregim.</p> <p>Të interpretojë në lojën me role pjesë të ndryshme sipas llojit që ato përfaqësojnë .</p> <p>Të fitojë një teknikë recitimi të qartë, saktë dhe të pëlqyeshme për të tjerët.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Diskutojnë për lloje e gjini të veçanta letrare, si: vjersha, përralla, tregime ,gjëegjëza, fabula, fjalë të urta. . <p>Tregojnë përralla</p> <p>Interpretojnë vjersha</p> <p>Luajnë role të pjesëve të shkurtra të gjinisë dramatike.</p> <p>Bëjnë pyetje dhe u pergjigjen atyre.</p> <p>Vlerësojnë njëri- tjetrin për rolet.</p>
5. Të folurit duke përdorur njohuritë rreth gjuhës standarde.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të drejtshqiptojë gjithnjë të gjithë tingujt e fjalët. ➤ Të përdorë gjithnjë drejt theksin, në fjalët e njohura apo të reja. ➤ Të dallojë kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të figurshëm të fjalëve dhe të shprehjeve me vlera artistike dhe gjuhësore në materialin që lexon ose dëgjon 	<p>Tema të ndryshme që përmbajnë fjalë nga fusha të aktivitetit jetësor të fëmijëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Pasurimi i fjalorit me shprehje dhe terma nga fusha të ndryshme tematike.

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ T'i përdorë fjalët e reja sipas kuptimeve që ato marrin në kontekste të ndryshme ➤ Të pasurojë fjalorin me fjalë e shprehje specifike si dhe me ndërtime të tilla si: kryefjalë + folje, folje + kundrinë, folje + rrethanor duke përdorur foljet kam e jam në kohë të ndryshme, duke shmangur fjalët e huaja. 	
--	---	--

LINJA: TË LEXUARIT

Nënlinja	Objektivat	Tematika
1. Të lexuarit për të kuptuar tekstin e për të marrë informacion	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të lexojë rrjedhshëm, me intonacionin e duhur duke respektuar tekniken e të lexuarit dhe shenjat e pikësimit në mënyre të vetëdijshme dhe të qartë. ➤ Të bëjë pyetje rreth tekstit që ka lexuar për të treguar se ka një kuptim të vetëdijshëm panvaresisht nga lloji i shkrimit, për pjesën që ka lexuar. ➤ Të japë detaje shtesë rreth informacionit apo të udhëzimit, duke e pasuruar atë më tej. ➤ Të zgjerojë me detaje shtesë informacionin e marrë nga burime të ndryshme, si: libri, media, video, interneti, si dhe kanale të tjera informacioni. ➤ Të dallojë informacionin më të rëndësishëm nga informacioni i dorës së dytë për të bërë përgjithësime. ➤ Të përzgjedhë për qëllime të caktuara informacionin e domosdoshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tekste letrare dhe jo letrare që japin informacione, udhëzime e orientime nga fusha të ndryshme. ➤ Shkrime të llojeve të ndryshme; të shtypit, simbole, skema, harta, plane, diagrame, tabela, udhëzues. etj ➤ Informacione nga literatura ndihmëse: gazeta, revista, dokumente, shkollore, shtetërore. etj dhe ta kuptojë informacionin që merr për botën që e rrethon.
2. Të lexuarit për	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të lexojë me interes, emocion, dëshirë dhe me 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Pjesë që u ngjallin nxënësve emocione,

<p>dëshirë dhe për zhvillimin e ndjenjave</p>	<p>ndjenjë tekste të natyrave të ndryshme</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të përdorë tri format e leximit shprehës; vetjak, leximin e dramaturgjisë (me role) dhe leximin kolektiv.. ➤ Të krijojë lidhje ndërmjet filmave, figurave dhe historive të lexuara. ➤ Të listojë tiparet e personazheve që pëlqen, duke e mbështetur mendimin në pjesën e leximit për të cilën po flet: çilesitë e tyre fizike dhe morale. ➤ Të fantazojë për mjediset dhe për fatin e personazheve.. <p>Të bashkëbisedojë me personazhet e dashura për ëndrra të përbashkëta.</p>	<p>dëshirë për t'i lexuar deri në fund dhe u zhvillojnë ndjenja pozitive me tema nga: <i>shkolla, loja, fitorja, paqja, toleranca, të drejtat, detyrat, përgjegjësitë, dashuria, bashkëpunimi, ndihma, vendlindja, kozmosi etj.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Pjesë ku nxënësit gjejnë miqtë e tyre, heronjte e tyre, të tregimeve, përrallave pjesëve të shkurtra të gjinisë dramatike. ➤ Pjesë që përmbajnë fabula interesante, fjalë të urta, të cilat i nxisin nxënësit të tregojnë histori të ngjashme, interesante apo edhe ëndrra etj.
<p>3. Të lexuarit për të reflektuar mbi idetë e tekstit.</p>	<p>Të tregojë brendinë e pjesës që lexon.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të ndajë pjesën në fragmente të vecanta, sipas kuptimit të tyre duke hartuar saktë pikat e planit. <p>Të gjejë idetë dhe mesazhin e pjesës së lexuar duke ilustruar idetë me fragmentet përkatëse.</p> <p>Të shfaqë mendime personale nëse tema e pjesës që lexon ka lidhje me botën dhe interesat e tij.</p> <p>Të analizojë personazhin kryesor në mënyra të dëshirueshme nga vetë nxënësi..</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tekste letrare dhe jo letrare të pasura me të dhëna e detaje kryesore, që i nxjerrin qartë idetë dhe mesazhin e pjesës. ➤ Tekste që përshkruajnë mjedise, njerëz, kafshë, bimë të vendeve të ndryshme, në kohra të ndryshme. <p>Tekste që i motivojnë nxënësit të reflektojnë idetë në mënyra të ndryshme: me anë të dramatizimeve, recitimeve, vizatimeve, diagrameve, shkrimeve, poezive, konkurseve etj.</p>
<p>4. Të lexuarit e llojeve dhe gjinive letrare</p>	<p>Të përzgjedhë për të lexuar pjesë që u përkasin llojeve dhe gjinive të ndryshme letrare.</p> <p>Të klasifikojë elemente të stilit dhe të gjuhës të tilla, si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu, dialogu,</p>	<p>Pjesë të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare, si: përralla, tregimi, vjersha gjëgjëza, drama, fabula, fjalë të urta, libra, gazetatat të krijuara nga</p>

	<p>monologu, didaskalia, viza, trepikëshi etj.</p> <p>Të dallojë elementet karakteristikë të prozës nga poezia, tregimit nga fabula e perralla, librat nga gazetatat, të prozës dhe poezisë nga drama.</p> <p>Të shprehë pëlqimin ose mospëlqimin për lloje e gjini të veçanta.</p>	<p>fëmijët...</p> <p>Pjesë në të cilat dallohen tipare të llojeve e gjinive të ndryshme që nga mënyra e renditjes së fjalëve, e organizimit të faqes, të përzgjedhjes së figurave, gjuhës, titullit, paragrafëve, vargut, monologut, dialogut, fjalëve të autorit (didaskalitë) etj.</p>
<p>Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të respektojë intonacionin e duhur gjatë leximeve me zë të lartë të pjesëve në poezi apo në prozë qofshin në mënyrë tërheqëse për të tjerët.. ➤ Të demonstrojë të lexuar me intonacion, ritëm dhe theks sipas llojit të tekstit , duke u bazuar në imitimin e modeleve më të mira. ➤ Të luajë në role figura të personazheve të tregimeve dhe të përrallave të lexuara. ➤ Të imitojë zërin e një personi që flet; në një transmetim veprimtarie sportive, emision TV, reklamë, batutë, film etj.. ➤ Të luajë në role personazhin që pëlqen më shumë 	<p>Pjesë që duke u lexuar në mënyrë shprehëse ngjallin emocion te dëgjuesit.</p> <p>Pjesë të transmetuara në radio e televizion që duhen imituar nga nxënësit (tempi, ritmi, theksi).</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Pjesë që kur recitohen apo interpretohen në role ngjallin emocione tek nxënësit.
<p>6. Të lexuarit për të pasuruar njohuritë në drejtim të gjuhës standarde shqipe</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të drejtshqiptojë gjithnjë të gjithë tingujt e fjalët. ➤ Të përdorë gjithnjë drejt theksin, në fjalët e njohura apo të reja. ➤ Të dallojë kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të figurshëm të fjalëve dhe të shprehjeve me vlera artistike dhe gjuhësore në materialin që lexon . ➤ T'i përdorë fjalët e reja sipas kuptimeve që ato marrin në kontekste të ndryshme. ➤ Të dallojë pjesët kryesore dhe plotësuese të fjalisë duke i përdorur ato në përputhje me kontekstin në të 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Pjesë dhe tekste që i pasurojnë të folurit e nxënësve me terma të tilla, si: autor, titull, faqe, vjershë, strofë, varg, tregim, përrallë, paragraf, rresht, teatër, rol, figurë, gjëegjëzë, përgjigje, personazh, hyrje, mbyllje, ide, rol, fjalor, dialog, monolog, fjalet e autorit (didaskalitë) .

	<p>cilin jepet.</p> <p>➤ Të dallojë llojet e ndryshme të fjalive nga intonacioni, shenjat e pikësimit etj,</p>	
--	--	--

LINJA: TË SHKRUARIT:

Nënlinjat	Objektivat	Tematika
<p>1. Të shkruarit me karakter funksional duke kuptuar vlerat e shkrimit si element komunikimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të shkruajë sipas modeleve të dhëna për punë me shkrim të tipit : këshilla, udhëzime, njoftime, përshkrime, thirrje etj. • Të shkruajë për qëllime të ndryshme. • Të shkruajë për lexues të ndryshëm. • Të japë informacione të shkurtra me shkrim, të bëjë pyetje me shkrim, t'u përgjigjet atyre dhe pyetësorëve të thjeshtë. • Të bëjë shkrime të shkurtra të natyrave të ndryshme. • Të plotësojë drejt paragrafë të modeleve të ndryshme. 	<p>Modele shkrimesh me karakter funksional të tilla si: letra, këshilla, kujtime, formularë, përshkrimin e ambientit ku jeton , thirrje për miqësinë etj.</p> <p>Modele nga materiale të ndryshme të përshtatshme për këtë moshë të karakterit informues, të tilla si: Enciklopedia për fëmijë, fjalorë për këtë moshë, antologji për fëmijë etj.</p> <p>Modele gjysmë të gatshme ku nxënësi duhet të plotësojë fjali ose paragrafë që mungojnë.</p>
<p>2. Të shkruarit për qëllime vetjake dhe më gjerë</p>	<p>Të bëjë shkrime të ndryshme për nevoja vetjake.</p> <p>Të kërkojë ndihmë ,të lërë një mesazh, të japë një përgjigje me shkrim.</p> <p>Të plotësojë plane veprimtarish argëtuese, sportive.</p> <p>Të ndërtojë orarin e veprimeve në veprimtari të ndryshme.</p> <p>Të mbajë shënime të qëllimshme nga leximet e bëra.</p> <p>Të mbajë shënime vetjake nga leximet e bëra</p>	<p>Modele shkrimesh ku shprehen nevoja vetjake: kërkon ndihmë, jep përgjigje me shkrim, lë mesazhe.</p> <p>Modele shkrimesh ku bëhet fjalë për veprimtari të tilla si: një festë në klasë, një veprimtari sportive, një veprimtari mjedisore apo njohëse dhe edukuese me rregullat e qarkullimit rrugor.</p>

	<p>përmes burimeve të ndryshme dhe fushave jashtëshkollore.</p> <p>Të përdorë fjalët dhe termat e duhur në një këshillë për rregullin në klasë, për riqarkullimin e mbeturunave, formular, plan i thjeshtë pune apo veprimtarie, thirrje për veprime qytetare etj</p>	<p>Materiale me tekste ku nxënësit i kërkohet të bëjë përzgjedhjet e duhura.</p> <p>Materiale me tekste ku nxënësve u jepen modele shkrimesh si psh: këshilla për rregullin në klasë, për riqarkullimin e mbeturunave, formular, plan i thjeshtë pune apo veprimtarie, thirrje për veprime qytetare etj</p>
<p>3. Të shkruarit për t'u shprehur me ndjenjë dhe me imagjinatë</p>	<p>Të bëjë shkrime të ndryshme, ku nxënësit i duhet të shprehë ndjenja dhe emocione të tij.</p> <p>Të shkruajë duke përshkruar të afërm, shokë, kafshë etj.</p> <p>Të përshkruajë personazhe, krijime të imagjinatës popullore apo letrare.</p> <p>Të përshkruajë ngjarje, mjedise jo të vërteta duke u mbështetur në imagjinatën e nxitur nga fantazia njerëzore në përralla, legjenda, mite etj.</p> <p>Të shkruajë me ndjenjë për përvoja vetjake.</p> <p>Të shkruajë mbi bazën e figurave dhe imagjinatës së tij tekste të shkurtra të strukturuar.</p>	<p>Modele shkrimesh të ndryshme ,ku nxënësi shpreh ndjenja dhe emocione të ndryshme.</p> <p>Materiale të ndryshme që paraqesin situata jetësore të moshës së tyre.</p> <p>Tekste të ndryshme letrare me personazhe të dashur për fëmijë si: mamaja, gjyshja, një shok ose shoqe, një kafshë shoqërimi etj.</p> <p>Përralla të shkurtra, legjenda, fabula me personazhe fantastikë si: shtriga, zana, Muji, dragoi, Pinoku, Gishtoja, Piter Pani etj.</p> <p>Ilustrime me figura ku nxënësit shkruajnë ose vazhdojnë ndodhi sipas fantazisë së tij.</p> <p>Tekste të shkurtra me karakter fantastko-shkencor. Ilustrime me figura ku shkruajnë ndodhi sipas fantazisë së tyre.</p> <p>Tekste, pjesë ku nxënësi të përdorë terma</p>

4. Njohuri rreth sistemit të gjuhës: 45 orë

Nënlinja	Objektivat	Tematika
1.Sintaksë	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të dallojë një tekst nga një grup fjalish që nuk kanë lidhje kuptimore. ➤ Të shkruajë vetë një tekst. ➤ Të dalloje fjalitë dhe paragrafët në një tekst ➤ Të renditë sipas rrjedhës logjike paragrafët në tekst ➤ Të dallojë grupin e kryefjalës dhe të foljes, percaktorin, kundrinorin. rrethanorin në fjali. ➤ Të përshtatë foljen me kryefjalën. ➤ Të kryejë veprime me grupet e fjalëve në fjali. ➤ Të dallojë fjalinë me të vogël. ➤ Të zgjerojë ose të shkurtojë strukturat e fjalive. ➤ Të zgjerojë grupin e kryefjalës dhe foljes në fjalitë që i kërkohen. 	<p>Teksti dhe fjalia</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Grupet kryesore të fjalëve në fjali (kryefjala, folja, rrethanori, kundrinori). ➤ Kryefjala. ➤ Përshtatja e foljes me kryefjalën. ➤ Veprime brenda fjalive. ➤ Grupe të lëvizshme dhe grupe të palëvizshme ➤ Grupi emëror. Përcaktori.
2. Morfologji	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të dallojë emrin. ➤ Të analizojë emrin. ➤ Të dallojë mbiemrin ➤ Të analizojë mbiemrin. ➤ Të dallojë ndajfoljen dhe llojin e saj ➤ Të dallojë lidhëzat. ➤ Të dallojë përemrin pronor. ➤ Të përdorë në fjali foljet ndihmëse kam, jam në kohë të thjeshta. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Emri ➤ Emri. lakimi i emrit. ➤ Mbiemri ➤ Ndajfolja ➤ Lidhëzat ➤ Përemri pronor. ➤ Folja.
3. Drejtshkrim + Pikësim	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të shkruajë qartë dhe me estetikë. ➤ Të dallojë dhe përdorë shenjat pikësimit: pikë, pikëpyetje, pikeçuditësen, pikëpyetje+pikëçuditëse. ➤ Të përdorë saktë shenjat e pikësimit në dialog. ➤ Të përdorë shkronjat e mëdha me korrektësi në fillim të fjalisë, në emrat e njerzve dhe në raste të tjera të përdorimit të tyre. ➤ Të shkruajë qartë shkronjat e alfabetit të mëdha e të 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Shenjat e pikësimit (.) (,) (?) (!) (!?) ➤ Shenjat e pikësimit në dialog. ➤ Shkronja e madhe. ➤ Emrat mashkullorë që mbarojnë me -ër,-ës. ➤ Emrat femërore që mbarojnë me zanoren-i ➤ Emrat që mbarojnë në shumës me -e ➤ Drejtshkrimi i mbiemrave të nyjshëm ➤ Drejtshkrimi i lidhëzave.

	<p>vogla.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të shkruajë drejt formën e emrave që mbarojnë me –er,-es gjatë lakimit të tyre. ➤ Të shkruajë drejt format e emrave femërore që mbarojnë me zanoren –i gjatë lakimit të tyre. ➤ Të shkruajë drejt formën e emrave që në numrin shumës mbarojnë me –e ➤ Të përshtatë gjininë e mbiemrit të nyjshëm me gjininë e emrit që shoqëron. ➤ Të shkruajë drejt zanoren (ë) në fjalë dhe në vendndodhje të ndryshme në trup të fjalës. ➤ Të shkruajë drejt lidhëzat si dhe fjalë e shprehje lidhëzore. ➤ Të ndajë fjalët në fund të rreshtit. ➤ Të zbatojë rregullat drejtshkrimore gjatë shkrimit me të kopjuar, diktuar ose në krijime. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Drejtshkrimi i zanores-e. ➤ Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit. ➤ Ushtrime drejtshkrimore ➤ Dikttime
<p>3. Leksikologi Fjalëformim</p>	<p>Të njohë si koncepte; sinoniminë, antoniminë. Të krijojë çifte sinonimie, antonimie..</p> <p>Të dallojë fjalë me kuptime të figurshme në të folur e në të dëgjuar.</p> <p>Të shpjegojë kuptimet e figurshme.</p> <p>Të dallojë ndryshimin kuptimor dhe ngjyresën emocionale në fjalët me prapashtesa zvogëluese e përkëdhelëse.</p> <p>Të dallojë rolin e parashtesave në krijimin e kuptimeve antonimikë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ●Sinonimia e fjalëve. ●Antonimia e fjalëve. ●Fjalë me kuptime të figurshme. ●Fjalë me prapashtesa zvogëluese e përkëdhelëse. ●Fjalë që parashtesa formon kuptimin antonimik.

4. Kulturë gjuhësore	<p>Të njohë ndërtimin e një fjalori dhe të një fjalorthi. Të përdorë modele të shkruari të fjalorëve të thjeshtë me leksik të përshtatshëm për moshën dhe interesat e saj. Të përdorë fjalorth për qëllime të ndryshme. Të dallojë fjalët dialektore të gjuhës shqipe. Të dallojë fjalët e gjuhës standarde nga ato dialektore.</p>	<p>Fjalorth Dialektet Gjuha standarde</p>
-----------------------------	---	---

V. TABELA PËRMBLEDHËSE SHPËRNDARJES SË ORËVE

Nr	Linjat	%	Nr i orëve	Nënlinjat		orë
I	Të dëgjuarit & të folurit	15	26	1	Për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime	4
<p>Në praktikën e përditshme mësimore të gjitha orët e lëndës së gjuhës amtare kanë të integruar punën e planifikuar me të folurit dhe të dëgjuarit. Edhe pse janë shënuar 15 % në tabelën I, faktikisht në strukturën e zbatuar programore kjo linjë duhet të zërë një % shumë më të madhe të kohës mësimore për vetë karakterin specifik të lëndës. Ajo shoqëron pothuajse të gjitha prët.</p>				2	Të dëgjuarit dhe të folurit në grupe të vogla dhe të gjera.	5
				3	Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme	7
				4	Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe të gjinive letrare	5
				5	Të folurit duke përdorur njohuritë rreth gjuhës standarde	5
II	Të lexuarit	30	52	1	Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion	4
<p>Po kështu edhe për linjën e të lexuarit, është respektuar ndarja e orëve të të lexuarit në strukturë, ku zë 30% të kohës mësimore, por kjo</p>				2	Të lexuarit për dëshirë, për zhvillimin e ndjenjave dhe zgjim imagjinate.	15
				3	Të lexuarit për të reflektuar mbi idetë e pjesës.	12

<p>% rritet në të vërtetë gjatë praktikës mësimore, sepse edhe në linjat e tjera nuk do mund të zhvilloheshin po të mos integrohet të lexuarit.</p>						
				4	Të lexuarit e llojeve e të gjinive letrare.	12
				5	Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje.	6
				6	Të lexuarit në praktikim të njohurive rreth gjuhës standarde shqipe.	3
III	Të shkruarit	15	26	1	Të shkruarit funksiona lduke kuptuar vlerat e shkrimit si element komunikimi.	8
<p>Për vetë rëndësinë që kjo linjë ka në praktikën mësimore dhe më gjerë, në jetën e përditshme të secilit nxënës edhe pse në tabelën III paraqitet me 15% dmth 26 orë, faktikisht në strukturën lëndore vjetore zë gati trefishin e tyre. Të shkruarit ka rreth 40% të sasisë së kohës mësimore aktive në klasë.</p>				2	Të shkruarit për nevoja vetjake, të përdorë atë për shumëllojshmëri qëllimesh.	10
				3	Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë, të shkruajë në mënyrë të strukturuar.	8
IV	Njohuri rreth sistemit gjuhësor	25	45	1	Sintaksë	11
<p>Edhe për linjën e tabelës IV do të funksionijë e njëjta logjikë, sepse është e vërtetë që njohuritë rreth sistemit gjuhësor zënë 30% të orëve të programit mësimor, por është gjithashtu e vërtetë që në linjat e tjera; të folurit, të lexuarit, të</p>				2	Morfologji	11
				3	Leksikologji+fjalëformim.	5

shkruarit nuk mund të mos integrohen njohuri gjuhësore. Ato njohuri ose janë vendosur në fund të linjave të tjera si nënlinjë më vete ose janë integruar në mënyrë të pandashme brenda tyre.	4	Kulturë gjuhe	4
	5	Drejshqiptim, drejtshkrim, pikësim	14
V	Dispozicion	15%	26 orë
Orët do të planifikohen nga mësuesi, ku dhe si ai ta shohë të nevojshme gjatë praktikës së përditshme mësimore. Në program është paraqitur një rubrikë në ndihmë të tij për përdorimin e kësaj sasive orësh të lira.			

Zbatimi i kurrikulës së lirë

Qëllimi i **Orëve të lira** (15% e orëve totale) është t’i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës dhe të mësuesit për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministri e Arsimit dhe Shkencës dhe të përparësive arsimore që vendos mjedisi i veçantë në të cilin zhvillohet procesi i arsimit.

Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm , sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël, sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësuesit të lëndës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, Dejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Materiali mësimor që do të përgatitet dhe do të përzgjidhet nga mësuesi duhet t’ shërbejë realizimit të objektivave të programit dhe synimeve të përgjithshme të lëndës gjuha amtare si lëndë formuese, edukimin e tij global, si një ndërlëndë rrezatimi i rezultateve të së cilës kushtëzon mbarëvajtjen e nxënësve në lëndët e tjera të sistemit kurrikular dhe ekstrkurrikular.

Grumbullimi, sjellja në klasë dhe përdorimi i materialeve të ndryshme nga fusha të ndryshme të veprimtarisë intelektuale dhe praktike të nerëzimit, materiale letrare dhe joletrare, grafikë, diagrame, materiale nga media e shkruar dhe vizive, interneti, arkeologjia, astronomia, ekologjia, shëndeti i fëmijës, lojra të ndryshme të popujve të ndryshëm, edukimi qytetar, fjalorth të specializuar për fusha që paraqesin interes për moshën etj, mund të kthehen në burme të vlefshme për të organizuar orë mësimore “pa mure” që janë interesante dhe bëhen promotorë edhe të zgjedhjeve afatgjata të nxënësve në jetë.

Organizimi i veprimtarive në natyrë jashtë mureve të shkollës duke shfrytëzuar kushte të mjedisit në të cilin është shkolla, të shoqëruara me veprimtari praktike; organizimi i vizitave në Biblioteka, teatro, muze, shtëpi muze shkrimtarësh, thjesht vende me bukuri natyrore të spikatur të vendit tonë, pra vende dhe qendra të rëndësishme për kulturën shqiptare për historinë e kombit që kanë

ndikuar fuqishëm në identitetin kulturor kombëtar, të shoqëruara me vrojtime dhe me detyra në shërbim të realizimit të objektivave të caktuara të programit. Kështu mund të bëhet;

Organizimi i konkurseve të fjalës artistike,

Organizimi i konkurseve “Lexuesi më i mirë,,

Organizimi i konkurseve “ veprimtaria më e mirë në shërbim të ruajtjes së mjedisit,,

Organizimi i lojrave të ndryshme zbavitëse që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive intelektuale dhe pjesmarrëse që fuqizojnë të nxënët edhe zhdërvjelltësojnë procesin e mësimdhënies, që zhvillojnë të menduarin logjik dhe kritik,

Përforcimi i njohurive përmes improvizimeve të dramatizuara apo lojës me role,

Organizimi i konkurseve për dramatizimin më origjinal,

Shkëmbim letrash me qëllim përforcimin e njohurive të marra në kapitullin e punës me shkrim të shoqëruara me metoda dhe strategji që fuqizojnë si mësimdhënien ashtu edhe të nxënët duke luajtur.

Organizimi i konkursit “Shkrimi më i bukur,,

Intervista më interesante në bashkëpunim edhe me prindërit për përvoja të përbashkëta edhe pse në kohë të ndryshme.

Përralla nga krahina prej së cilës janë.

Ekspedita folklorike, areologjike dhe raporti i mi i punës me shkrim.

Këto janë disa veprimtaritë rekomandues që sugjerohen të zhvillohen nga mësuesi në kuadrin e orëve që ai ka në rubrikën e orëve të lira në dispozicion.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve, rritjen e efektshmërisë së kurrikulës së shkollës mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera, duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët disa orësh (në formën e një projekti ose të një teme komplekse) për të programuar dhe zhvilluar veprimtari të përbashkëta që shfrytëzojnë lidhjet konceptuale ndërlëndore dhe aspekte kroskurrikulare. Nxënësve u jepet detyra që përfshijnë njohuri ndërlëndore dhe u shërben arritjes së objektivave të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe larmia e veprimtarive , duke iu gjetur vendin e duhur përgjatë vitit mësimor, është element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të rubrikës së orëve të lira. Kjo do të mundësohet duke analizuar me kujdes si programin ashtu edhe kërkesat që parashtrajnë veçoritë vendore.

Realizimi i sugjerimeve të mesipërme kërkon nga mësuesi jo vetëm aftësi krijuese, por edhe aftësinë e një hartuesi të vërtetë kurrikule, për rrjedhojë, edhe përgjegjësinë profesionale dhe qytetare që bart në vetvete ky rol.

Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar për qëllime rutinë, të cilat jo vetëm që nuk shënojnë risi, por ia humbin karakterin inovativ kësaj rubrike në kurrikulën shkollë.

VI. INTEGRIMI

Lënda e Gjuhës Amtare për klasën IV është bazuar në integrimin e lëndëve në vazhdim të integrimit mes dy disiplinave filluar në klasën II dhe III. Përparësitë e integrimit të gjuhës shqipe dhe leximit letrar janë:

Respektimi i parimit të integrimit mes linjave që e përbëjnë atë: ***të folurit të lexuarit të shkruarit,***

Rritjen e cilësisë së mësimdhënies, mësimnxënies, motivimit dhe vlerësimit shkencërisht larg ndarjes së dhunshme që këtyre disiplinave iu ishte bërë.

Përmirësimin e raportit teori-veprimtari praktikë në favor të kesaj të fundit duke punuar me lëndën gjuhësore si mundësuese e dhënies së mesazheve që përcjellin materialet letrare dhe joletrare me të cilat do të punohet .

Krijon mundësi për bashkëveprim normal të komponentëve përbërës gjuhësor dhe komunikues.

Rritjen e aftësive vlerësuese dhe vetvlerësuese tek nxënësit, përmes qëndrimit të kujdesshëm të përdorimit të njohurive gjuhësore për të bërë të njohura opinionet, qëndrimet e tyre për probleme që ju interesojnë.

Lënda e Gjuhës Amtare është bazuar në integrimin e ndërlëndor që do të thotë se në zbauesit e këtij programi duhet të:

të realizojë parimin e integrimit natyrshëm të njohurive bazë nga fusha e sistemit gjuhësor të shqipes, dhe mes fushave të tjera të dijeve, të tilla si: arti i fjalës, , historia, gjeografia, matematika, teknologjia, edukata qytetare, ruajtja e mjedisit, etj.

Të prezantojnë me njësi mësimore dhe me linja të caktuara zbatuesit e programit që të mund të realizojnë integrimin dhe synimete larmishme mësimore.

të zbatohet integrimi në program përmes respektimit të larmisë tematike.

Menyrat e integrimit

- Integrimi ndërlëndor (gjuhe shqipe, tekste letrare dhe joletrare të llojeve dhe gjinive të ndryshme)
- Integrim ndërmjet fushave të studimit (linjave dhe nënlinjave)
- Integrim në planin e bashkëveprimit të objektivave për çdo fushë
- Integrim në përdorimin e metodave ndërvepruese në mësimdhënie
- Integrimi nëpërmjet zbrërthimit të përmbajtjes lëndore nëpërmjet fushave të veprimtarisë së nxënësit
- Integrim përmes zbrërthimit të objektivave themelore si lëndë në objektiva specifike.

1.Me rëndësi parësore në formimin

INTELEKTUAL, SOCIAL DHE ATDHETAR TË NXËNËSIT TË KLASËS IV

Të ruajë dhe të respektojë karakterin kombëtar duke pasqyruar identitetin kulturor dhe duke e pasuruar atë me elemente të kulturave të tjera

- Të ndihmojë në formimin gjuhësor letrar dhe joletrar të nxënësve duke u mbështetur në zhvillimet më të reja gjuhësore
- Njohuritë gjuhësore t'i lidhë ngushtë me shprehjet komunikuese duke u mbështetur në modelet më të mira të fjalës së folur, të shkruar dhe të lexuar.
- Të jetë në bazë të çdo lënde mësimore, objektivat e së cilës të jenë të detyrueshme për procesin mësimor edukativ në shkollë.
- Të ndihmojë krijimin e marrdhënieve të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në klasë e më gjerë.

2.Integrim në metodë

- Të vendosë nxënësin në qendër të procesit mësimor duke u bazuar në studime të didaktëve të shquar të traditës ose bashkëkohore shqiptare e botërore si edhe nëpërvojat jetësore të tij.
- Përfshirjen dhe përdorimin e metodave, e mjeteve bashkëkohore didaktike për të rritur efektshmërinë e orës së mësimi dhe gjithpërfshirjen e nxënësve të shoqërohet dhe zhvillohet përmes përdorimit të materialeve të komunikimit masiv bashkëkohor të siguruar nga burime alternative.

VII . VLERËSIMI

Një nga proceset bazë që qëndron në themel të të mësuarit të lëndës gjuha amtare është vlerësimi i njohurive të nxënësve. Ky proces shënon përgjegjësi të rëndësishme dhe sigurisht kërkon agjornim me parametrat bashkëkohorë.

Synimet e vlerësimit janë:

- Sigurimi i informacionit të nevojshëm dhe shumë të rëndësishëm mbi nivelin e njohurive, motivimin e tyre drejt të mësuarit duke përcaktuar mundësitë e tyre reale për nxënie.
- Shkallja e realizimit të objektivave të përcaktuara në programin mësimor.
- Nxitjen e interesit të nxënësit për ngritjen e nivelit të arritjeve të tyre.

Komponentet e vlerësimit janë:

Vlerësim i vazhdueshëm me gojë dhe me shkrim.

- Për vetë natyrën e lëndës dhe rëndësinë e madhe të vlerësimit të aftësive komunikuese vlerësimi i vazhdueshëm me gojë dhe me shkrim është imperativ i punës së përditshme mësimore në këtë lëndë. Në dobi të nivelit të punës vlerësuese është pa dyshim vendosja e kriterëve vlerësues, njëhja e standardeve, të cilat janë në fakt, piketa të përcaktuara profesionalisht si rezultate të pritshme që duam të arrijmë, vlerësimi i nxënësit dhe nivelin e punës së bërë sipas standardeve të arritjes.

Nëse do të nisemi nga qëllimi i realizimit të vlerësimit atëherë do të vërejmë se vlerësimin mund ta klasifikojmë në:

- **Vlerësim formues**
Realizohet kur synojmë marrjen e informacionit mbi atë që ka arritur të bëhet pjesë e formimit të tij sipas objektivave të caktuar. Këtë indikator formimi mësuesi e përdor për të ndërhyrë dhe ndryshuar gjendjen përmes një mësimdhënieje më efektive dhe kalimin në objektiva të reja; minimalë apo të nivelit më të lartë. Dihet se konceptet gjuhësore janë të lidhura dhe sukcesi i objektivit varet nga shkalla e përvetësimit të atij pasardhës.
- **Vlerësim diagnostikues**
Për të gjykuar dhe marrë informacion për përgatitjen ditore të nxënësit dhe shkallën e përvetësimit të materialit të ri mësimor. Vlerësimi diagnostikues jep informacion mbi efektshmërinë e të nxënësit dhe ndihmon për ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies.
- **Vlerësim përmbledhës**
Ky vlerësim bëhet nga mësuesi në përputhje me objektivat mësimorë në fund të mësimin të disa kapitujve, semestrit ose në fund të vitit. Informacioni nga ky lloj vlerësimi është i plotë dhe rekomandohet të bëhet jo më pak se tre herë në vit.
- **Vlerësim motivues**
Qëllimi i këtij lloji vlerësimi është motivues, nxitës në drejtim të dëshirës dhe interesit të nxënësve për të mësuarit. Ndër format më efektive që rekomandohet të përdoret në shkollë është vlerësimi motivues, i cili nxit të mësuarit e nxënësve fuqishëm.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rrugët praktike e tradicionalisht të njohura, si: qortimet nga mësuesi. Praktikrat e reja sot orientojnë vendosjen e kritereve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve; të jenë të tilla që t'i motivojnë ata.

Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

VIII. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Të nxënësit e këtij proramit bëhet më cilësor kur:

Nxënësit në orën e gjuhës amtare të sjellin në klasë përvoja personale, interesa, qëndrime të caktuara ndaj dukurive gjuhësore. Mësuesit të adaptojnë një seri rolesh (ftuesit në bashkëpunim, dëgjuesit të vëmendshëm, inkurajuesit, udhëheqësit, mbështetësit, nxitësit, motivuesit, lehtësuesit, vlerësuesit etj) në procesin e të nxënësit.

Procesi mësimor në çdo temë duhet të shoqërohet me rubrika të pasura, paraqitje skemash dhe grafikësh të thjeshtë, të tillë si ato që nxënësi has në jetën e përditshme, ndërthurja e tyre synon ta mundësojë natyrshëm integrimin.

Rimarrja si një parim didaktik duhet të jetë pjesë e mësimin të gjuhës amtare, me qëllim lidhjen dhe përforsimin e shprehive letrare dhe gjuhësore.

Kërkohet që nxënësit të nxiten të jenë aktivë dhe të marrin përgjegjësi për të nxënësit e tyre.

Kërkohet që nxënësit t'u jepen shanse të dinë më shumë për dukuritë dhe ligjësitë gjuhësore dhe letrare.

Kërkohet që, në mësimin e lëndës “Gjuha amtare për kl. IV” duke u dhënë përparësi ushtrimeve, praktikimit të asaj që nxënësit dinë të bëjnë larg mbingarkesave teorike, ta kalojmë mësimdhënien nga riprodhuese, në një mësimdhënie ku nxënësi **kërkon, gjen, zbulon, zgjidh, analizon, provon madje të kalojë edhe në sintezë.**

Planifikimi i veprimtarive mësimore të tilla **si të lexuarit, të foluri individualisht ose në grup, të shkruarit**, kërkohet të jenë pjesë përbërëse e çdo ore mësimi,

si në pjesën teorike të temave të veçanta, ashtu edhe në pjesën praktike,

si në temat nga fusha e letërsisë dhe të disiplinave të tjera shkollore (përmes teksteve joletrare), ashtu edhe në temat nga fusha e gjuhës shqipe.

Punët me shkrim të tipit **ese, shkrim i lirë, përshkrim, portret apo modele të tjera të shkruari**, edhe pse të thjeshta, kërkohet të jenë të paraprirë nga njohje, analiza, imitime të krijimeve të të njëjtës natyrë shkëputur nga trashëgimia jonë letrare dhe ajo botërore. Ato duhet të jenë të shpeshta dhe me tematikë të larmishme, nxitëse veprimtarish, aktiviteteve të gjera gjithëpërfshirëse, kërkimore dhe aplikative.

Kërkesa për punë me shkrim për çdo temë mësimi në procesin mësimor, nuk duhet të varet apo plotësohet **vetëm** nga orët e veçanta të planifikuara për to në program, por duhet medoemos të bëhet pjesë përbërëse shtjellimit të plotë të temës përkatëse duke shtuar edhe kërkesa që lidhen me modelimin e shkrimit.

Ushtrime dhe forma pune ndërvepruese duhet të jenë në strukturën e zbatuesve të programit.

Mësimi i lëndës “Gjuha amtare për kl. IV”, kërkohet të bëjë kujdes në respektimin e raporteve midis pjesës teorike dhe asaj praktike të tij, raporte ; 70%-30%, në favor të pjesës zbatuese.

Kërkohet që procesi mësimor të pasurohet dhe të shoqërohet me **tabela, diagrama, grafike, foto dhe skica** të tjera, që shoqërojnë natyrshëm materialin verbal të shkruar.

Kërkohet të bëhet kujdes në pikpamje të mbingarkesës mësimore. Thjeshimi në terma, në përshtatje me moshën dhe sensin e masës në mësim, duhet pasur parasysh në mbarëvajtjen e zbatimit të këtij programi.

Rekomandohet që pjesët përfaqësuese nga letërsia shqipe dhe e huaj në përshtatje me moshën e fëmijëve të klasës katërt, të cilat të plotësojnë kriteret didaktike të gjatësisë, të strukturës dhe qartësisë së gjuhës t'u jepen nxënësve kënaqës duke i bërë të ndihen mirë në mësim.

